

Siguria Në Punë Dhe Mbrojtja E Shëndetit Në Sektorin Minerar

Rrapush Tola, Drejtor
**AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA**

HYRJE

Duke vlerësuar si tepër të rëndësishëm zhvillimin e punimeve të këtij aktiviteti në aspektin tërësor për sigurinë dhe shëndetin në punë, do të përqëndrohemi në fjalën time, tek siguria në punë dhe mbrojtja e shëndetit në sektorin minerar dhe në mënyrë të përmbledhur do të prezantoj veprimtarinë dhe qëllimin e Institucionit që drejtoj, **AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**, si institucion i vetëm kombëtar për sigurinë dhe emergjencat në miniera.

Fillimet e veta ky institucion i ka në vitin 1961, kur zhvillimi i industrisë minerare lindi nevojën e krijimit të Repartit të Inspektimit e Shpëtimit në Miniera “RISHM”, që kishte si qëllim kontrollin e sigurisë dhe shpëtimin, në veprimtarinë minerare. Sot, institucioni ka pesuar ndryshim të emërtesës nga Reparti Inspektim Shpëtim Miniera, në Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.

Gjatë kësaj periudhe, afërsisht 60 vjeçare, ky institucion ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e sigurisë dhe parandalimin e ngjarjeve të rënda në industrinë minerare.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, veç inspektimit të subjekteve minerare, kryen dhe detyrat e emergjencave dhe shpëtimit në veprimtaritë minerare, nëpërmjet skuadrave të shpëtimit, si dhe në emergjencat civile, kur është e domosdoshme ndërhyrja jonë.

Prej skuadrave shpëtuese të ketij institucioni janë kryer me dhjetra operacione shpëtimi, me shkallë të lartë rrezikshmërie, si:

- Shpërthime gazesh, zjarresh nëntokësore në minierat e qymyrgurit dhe bakrit; Shembjesh dhe përmbytjesh nga ujrat dhe llurbat;**
- 16 raste emergjencash civile;**
- 9 raste për nxjerrjen e viktimave të toksikuar nga gazet helmues, në puset e ujit të hapura nga banorët;**

SË PARI:

Shkurtimisht, për auditorin, dua të theksoj se sektori minerar në Republikën e Shqipërisë është:

- Element i rëndësishëm i strukturës ekonomike të vendit, i transformuar dhe riorganizuar tërësisht.
- Ka shtrirje dhe zhvillim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- E drejta e zhvillimit dhe shfrytëzimit të minierave, sot është tërësisht i përqëndruar në sektorin privat.
- Shteti zotëron vetëm të drejtën e pronësisë mbi këto pasuri.

Nisur nga ndryshimet, që ka pësuar sektori minerar, konkretisht:

- Është reformuar e plotësuar në tërësi Sistemi Ligjor, Administrativ dhe Teknik.
- Ka pësuar ndryshime dhe kuadri ligjor – organizativ, për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore, për sigurinë dhe garantimin e sigurisë në këtë sektor.
- Për zhvillimin e sektorit minerar janë dhënë afërsisht 1200 Leje Minerare (gjatë gjithë viteve) dhe janë efektive rreth 700 prej tyre. Në sektorin minerar janë të punësuar afërsisht 9500 –10.000 punonjës.

SË DYTË:

Theksoj se, në politikat shtetërore dhe qeverisëse, krahas zhvillimit sasior e cilësor, teknik e teknologjik të sektorit mineral, prioritet ka patur përcaktimi e kërkesave ligjore për të siguruar e garantuar sigurinë në punë në të gjitha etapat zhvilluese. Këtij qëllimi i shërbejnë miratimi dhe zbatimi i ligjeve, si më poshtë:

- Ligj nr 135/2016, datë 22.12.2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”.
- Ligj nr 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr 9126, date 29.07.2003 “Për përdorimin civil të lëndës plasëse në Republikën e Shqipërisë”

Këto ligje janë të plotësuar me një gamë të gjerë aktesh nënligjore si, Vendime të Këshillit të Ministrave, Rregullore Teknikës së Sigurimit në Miniera dhe Karriera.

RRJEDHIMISHT:

Nisur nga problematikat e hasura gjate viteve të fundit, për sigurinë në punë në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike dhe në punimet minerare të braktisura, me miratimin e ligjit nr.135/2016 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.214, datë 20.04.2018, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, ushtron kompetenca edhe inspektimin e sigurisë në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjitike dhe monitorimin e mbikqyrjes e minierave të mbyllyra dhe jashtë përdorimit.

Dua të përmend si element të rëndësishëm, faktin se në të gjithë legjislacionin shqiptar (përfshirë edhe atë të ndryshuar), për zhvillimin dhe sigurinë në miniera dhe në çdo akt tjetër nënligjor, gjejnë zbatim konventat ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Europian të ratifikuara nga Parlamenti Shqiptar, si:

- Konventa nr. 174 “Parandalimi i Aksidenteve të Rënda në Industri, 1993”
- Konventa nr. 155 “Për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, 1981”
- Konventa nr.176 “Për sigurinë dhe shëndetin në miniera,1995”

Masat e marra nga ISHPSHSH për zbatimin e Legjislacionit të Punës

- Në faqen zyrtare të ISHPSHSH-së tashmë është integruar dhe është e aksesueshme edhe platforma “Matrica e Dënimeve”.
- Kjo platformë është projektuar me qëllim sigurimin e transparencës së vendimarrjes të inspektoreve të punës, pasi ishte konstatuar që nuk përdorej i njëjti standart për të gjithë shkelësit e ligjit. Duke e konsideruar si domosdoshmëri vendosjen e standarteve në procesin e inspektimit të punës, para se të kërkojmë zbatimin e standarteve të punësimit nga biznesi, përmes Platformës “Matrica e Dënimeve” synojmë;
- Të ulim në maksimum abuzimin me detyrën nga inspektorët e punës, duke e bërë procesin e vendimarrjes plotësisht transparent.
- Te ndikojmë drejpërsëdrejti në rritjen cilësore të inspektimit të punës, duke e bërë atë sa më profesional.

SË TRETË:

Ky Institucion, realizimin e zbatimit të kërkesave ligjore të sigurisë e kryen nëpërmjet realizimit të katër funksioneve kryesore, si:

- Inspektim i çdo vendi punë, në çdo veprimtari minerare, si proces kontrolli dhe konstatimi i problematikave, parandalimi i ngjarjeve të rënda, si dhe këshillimi e urdhërimi për zbatimin e kërkesave ligjore të sigurisë në veprimtarinë minerare.**
- Sigurimi dhe garantimi i mbështetjes së menjëhershme të çdo subjekti mineral në raste të emergjencave nëntokësore dhe marrjen e masave për shpëtimin e jetës së njerëzve apo në ngjarje të ndryshme të jetës civile (Zjarre në banesa, hapje puseh për ujë, etj)**
- Inspektim i vendit të punës në çdo subjekt që përdor lëndë plasëse në aktivitetin mineral, si dhe në inxhinierinë civile.**
- Inspektim i minierave të mbyllura e të konservuara, si dhe mbyllja e punimeve për parandalimin e rreziqeve në minierat e braktisura.**

- Funkzioni themelor për të vlerësuar sigurinë në punë dhe parandaluar rreziqet, avaritë në veprimtaritë minerare apo punimet nëntokësore të inxhinierisë civile është INSPEKTIMI.
- Për realizimin e këtij funksioni Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, ka përcaktuar kategorizimin e subjekteve minerare, në bazë të riskut mbi të cilën janë vendosur dhe normat e kryerjes së inspektimeve:
- Në veprimtaritë minerare nëntokësore me regjim gazi, inspektimi kryhet jo më pak se 3 (tre) herë në vit.
- Në veprimtaritë minerare nëntokësore pa regjim gazi, inspektimi kryhet jo më pak se 2 (dy) herë në vit.
- Në veprimtaritë minerare sipërfaqësore, inspektimi kryhet jo më pak se 1 (një) herë në vit.
- Në veprimtaritë minerare nëntokësore të veprave hidroenergjitike dhe grykat e mbyllura të minierave të braktisura, inspektimi kryhet jo më pak 1 (një) herë në vit.

Proçedurat për kryerjen e inspektimeve realizohen në zbatim të ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

- Të gjitha inspektimet e kryera nga AKSEM, janë të programuara për çdo vit e për çdo muaj.
- Të gjitha inspektimet e kryera nga AKSEM, duke filluar nga muaji prill 2018 kryhen nëpërmjet platformës elektronike (on – line).
- AKSEM realizon mbi 700 inspektime ne vit.

Inspektime të paprogramuara kryhen vetëm në rastet kur:

- Ndodhin ngjarje të rënda në veprimtaritë minerare.
- Nga informacionet e siguruara nga subjekte apo institucione publike arrihet në përfundim të nevojës për Inspektim.
- Konstatohet në kushte flagrante shkelje ligjore për sigurinë në punë.
- AKSEM realizon përafërsisht 25 –30 Inspektime jashtë programit ne vit.

Në zbatim të ligjit dhe gjëndjes konkrete të zhvillimit të veprimtarisë minerare, procesi i inspektimit fillon duke patur parasysh çdo etapë të procesit, si më poshtë:

- Përgatitja për inspektim fillon me hartimin e programit mujor 15 ditë, para fillimit të muajit pasardhës.**
- Gjenerimi i programit duke krijuar në sistem çështjet e inspektimit, si dhe caktimi i grupeve të inspektorëve që do të realizojnë inspektimin.**
- Subjekti që është objekt inspektimi, njoftohet 3 –5 ditë para inspektimit.**
- Grupi inspektorëve njihet me problematikën dhe detyrat e lëna në kontrollet e mëparshme në subjektin e inspektimit.**
- Për çdo subjekt lëshohet Autorizimi Inspektimit nga Kryeinspektori.**

REALIZIMI INSPEKTIMIT, KONSISTON NË:

- **Kontrollin e çdo vendi punë të veprimtarisë minerare.**
- **Konstatimet dhe nxjerrjen e përfundimeve mbi gjëndjen e sigurisë në objektet minerare.**
- **Lënia e detyrave për përmirësimin e të metave të konstatuara.**
- **Në rastet e shkeljeve të rënda ligjore apo teknike, si dhe në rastet e përsëritura,**
- **vendosjen e masave administrative konform ligjeve dhe aktevev nënligjore për sigurinë në punë.**

VENDIM MARRJA DHE KONKLuzionET, KONSISTOJNË NË:

- **Formim të subjektit për paqartësi ligjore.**
- **Këshillim i subjektit të inspektuar, për zbatim korrekt të kërkesave ligjore**
- **Urdhërim (detyra) për korigjimin e shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminim të pasojave që rrjedhin prej tyre.**
- **Vendosja e dënimit administrativ.**
- **Shqyrtimi i ankesave të subjektit të inspektuar dhe vendimi përfundimtar i njoftohet subjektit.**

Së katërti:

Në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjenat në Miniera është e organizuar dhe veprimtaria emergjencës dhe shpëtimit. Ky funksion kryhet nga një trup e posaçme e trajnuar dhe organizuar në Drejtorinë e Emergjencës dhe Shpëtimit, e quajtur ndryshe “skadër emergjence dhe shpëtimit”.

- **Realizimi i këtij funksioni është i plotësuar me rregullore të veçantë dhe me detyra të përcaktuara:**
- **Për organizimin e shërbimit të emergjencave dhe shpëtimit në subjekte.**
- **Përgatitjen dhe ruajtjen e gadishmërisë së trupës së shpëtimit në AKSEM.**
- **Bashkëpunimi, koordinimi dhe trajnimi i përbashkët i grupeve shpëtuese të subjekteve dhe atij të AKSEM.**
- **Sigurimi i burimeve njerëzore, materiale e financiare për realizimin e ndërhyrjeve në ngjarje.**

SË PESTI:

AKSEM kryen inspektime edhe në veprimtarinë e subjekteve që përdorin lëndë plasëse në punime të ndryshme të inxhinierisë civile (nëntokësore apo sipërfaqësore) dhe në funksion të disiplinimit të punës me lëndë plasëse, AKSEM realizon:

- **Inspektimin e cdo subjekti qe kryen punime me lende plasese Trajton ne komision teknik dhe pajis me deshmi (libreze) zjarrmetari cdo punonjes qe merret me perdorimin e lendes plasese ne Republiken e Shqiperise.**
- **Miraton pas shqyrtimit ne komision teknik projektet teknike te puneve me lende plasese te cdo subjekti qe kerkon te pajiset me Autorizim per perdorim civil te lendeve plasese.**
- **Miraton pas shqyrtimit ne komision teknik projektet e cdo subjekti per ndertimin depove te magazinimit dhe ruajtjes se lendes plasese.**
- **AKSEM pajis çdo vit me dëshmi zjarrmëtari, afërsisht 80 – 100 persona.**
- **Miraton 20 – 25 projekte teknike per punime me lende plasese.**
- **Miraton 10 –15 projekte per ndertimin e depove te lendeve plasese.**

SË GJASHTI:

Për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në miniera pas transformimit të sektorit dhe ndryshimit të strukturës së shfrytëzimit e përpunimit të minierave, si rezultat i ekonomisë së tregut, janë vlerësuar e përballuar nga ana jone, sfidat e lindura dhe problemet e trashëguara.

Ndër to, mund të përmendim:

- Pas viteve 90’ sektori minerar kaloi një krizë të rëndë e shoqëruar në mbylljen e minierave për një kohë të gjatë dhe dëmtim të punimeve, mjeteve, instalimeve, pajisjeve dhe largim masiv të fuqisë punëtorë të kualifikuar (emigracion, pension etj.)
- 80 % e lejeve minerare të dhëna janë për miniera e punime minerare të vjetra, e si rrjedhim, ka qenë dhe mbetet pengesë aplikimi teknikave e teknologjive të reja.
- Mungesa e punonjesve të kualifikuar për sektorin minerar.

Në mjaft zona minerare të vendit, sidomos ku është zhvilluar aktivitet për shfrytëzimin e gypmygurit dhe bakrit, ka ndodhur braktisja e punimeve, pa marrë masa për sigurinë.

Nisur nga kjo situatë në detyrat që kryen AKSEM është shtuar edhe procesi i monitorimit të minierave të braktisura. Me fonde të veçanta të vendosur në dispozicion nga qeveria është bërë e mundur mbyllja e 270 punimeve minerare të braktisura, si dhe vazhdon puna për mbylljen e rehabilitimin e ambientit në 250 punime të tjera minerare.

SI PËRFUNDIM:

Mund të themi se:

- Sfida jonë, si autoritet sigurie në punë, në një nga veprimtaritë me riskun më të lartë është që nëpërmjet punës sonë inspektuese, të ulim në minimum rastet e ngjarjeve aksidentale të çdo lloji në veprimtarite minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjitike.

Faleminderit